

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues, Agim Ademi, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit M. F., nga fshati K., Komuna e R., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati I. D. nga Gj., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan- Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr. 154/2016, të datës 18.07.16, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 27.09.2016, bie dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri M. F., nga i ati N., dhe nëna S., e lindur Z., i lindur..., në Gj., tani jeton në f. K. i E. Komuna e R., i pa martuar, i pa punësuar, ka të kryer shkollën e mesme të ..., i gjendjes së varfër ekonomike, Serb Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me datë ... 2016, në fshatin K. i E. komuna e R. në afërsi të shtëpisë së tij, pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armën e zjarrtë, edhe ate: një pushkë automatike ... prodhim “...” e K., kalibër ..., mm, me numër serik ..., ... copë fishekë të kalibrit ..., të njëjtës armë si dhe ... karikator të zbrazët e të cilat ditën kritike, gjatë bastisjes që i është bërë shtëpisë

dhe objekteve përcjellëse të të pandehurit, nga zyrtarët policor, i janë gjetur dhe sekuestruar.

Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7,17,21,46, 69,114, të KPRK-së dhe neneve 365, 453 të KPPRK-ës.

E G J Y K O N

Të akuzuarin M. F., me dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro, të cilën gjobë i akuzuari do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën Gjykata do të ia zëvendësoi me dënim burgu ashtu që do të i llogaritet shuma prej 20 (njëzet) euro për një ditë burgimi.

Të akuzuarit i shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i një pushkë automatike ... prodhim ... e K., kalibër ..., mm, me numër serik ..., ...copë fishekë të kalibrit ...,

Obligohet i akuzuari që ti paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda ka paraqitur aktakuzë PP.I nr. 154/2016, të datës 18.07.2016, kundër të akuzuarit M. F., nga fshati K. Komuna e R., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374

par.1. të KPRK-ës, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim merititor sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda Arben Kadriu, fillimisht mbeti në tërësi pranë aktit akuzues derisa me pas shtoi se i propozoj gjykatës që ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese pranimin e fajësisë dhe premtimin e tij se nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethanë rënduese shkallën e përgjegjësisë penale.

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i të akuzuarit M. F. avokati I. D. shtoi se pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjatë kësaj seance fillestare, të merren parasysh rrethanat lehtësuese edhe atë, se është penduar thellë për veprën penale të cilën e ka kryer, është i moshës relativisht të re, është i gjendjes se dobët ekonomike ,më parë nuk ka qenë i dënuar andaj i propozoj gjykatës që të akuzuarin M. F. ta shpall fajtor për këtë vepër penale por me rastin e shqiptimit të dënimit ti shqiptoj një dënim me kusht eventualisht një dënim me gjobë minimale.

I akuzuari M. F. fillimisht e pranoi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë dhe shtoi se përkrahë në tersi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij avokat, I. D. , se asnjëherë më parë nuk është ndeshur me ligjin, premtonte se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, andaj kërkoi nga gjykata që ti shqiptohet një dënim sa më i but që është i mundur.

Gjykata bëri shikimin dhe analizimin e provave materiale edhe atë: formular prone, i datës2016 procesverbali mbi bastisjen e banesave, lokaleve dhe personave i datës2016, vërtetimi mbi konfiskimin e armëve i datës2016 raporti i këqyrjes në vend të ngjarjes i datës2016, si dhe foto dokumentacioni dhe atë 12 foto si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit erdhi në përfundim se i akuzuari M. F., në mënyrë të paautorizuar në shkelje të ligjit të zbatueshëm, ka mbajtur në pronësi armë zjarri edhe atë një pushkë automatike ... prodhim “...” ... kalibër ... mm, me numër serik ..., ...copë fishekë të kalibrit ... të së njëjtës armë si dhe ... karikator të zbrazët, dhe se e njëjta i është sekuestruar nga ana e policisë, me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1.të KPRK-ës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenit 73 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë duke shprehur keqardhje të thellë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, si dhe moshën e tij të re, ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit për veprën penale dhe rrezikshmërinë shoqërore duke qenë se posedimi i

armës pa leje paraqet rrezik për popullatën. Në prezencë të rrethanave të shumta lehtësuese e si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë, të akuzuarit ju është shqiptuar dënim sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës.

Vendimi mbi dënimin plotësues konfiskimi i një pushkë automatike ... prodhim “...” e ..., kalibër ..., mm, me numër serik ..., ..., copë fishekë të kalibrit ..., është bazuar me nenin 69 dhe 374 paragrafi 3 të KPRK-së

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 163/2016 Me datë. 27.09.2016**

Sekretarja juridike,
Naile Neziri

Kryetari i trupit gjykues
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Krimeve të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.